

VENDIM
Nr. 6, datë 15.1.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 7/1 prot., datë 13.1.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Nova Solar System’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 7 prot., datë 6.1.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, dhe “d”; për pikën 1.3 germën “c”; si dhe pikën 2.5.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **Germa “b”:** Duhet të depozitohet dëshmia e penalitetit për vetë shoqërinë.

- **Germa “c”:** Në dokumentin e strukturës organizative duhet të saktësohen ortakët dhe të plotësohet vendimi i organeve drejtuese për miratimin e strukturës. Po ashtu, shoqëria duhet të depozitojë informacion mbi stafin aktual efektiv.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **Germa “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime tatimore të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- **Germa “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë vendimin e organeve drejtuese të saj, ku të dedikohet shuma përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Nova Solar system” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti